



KOMISIONI RREGULLATOR
I ENERGJETIKËS DHE I SHËRBIMEVE TË
UJIT
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË
VERIUT



NJOFTIM PËR OPINIONIN

Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit miratoi vendimin, me të cilin bëhet **ulja e çmimeve të shitjes me pakicë të derivateve të naftës mesatarisht për 0,38%** në raport me vendimin e datës 19.04.2021.

Çmimet e shitjes me pakicë të benzinës **EUROSUPER BS-98, të EURODIZELIT (D-E V) dhe të Vajit Ekstra të Lehtë për Amvisëri (EL-1) nuk ndryshojnë**, respektivisht mbeten në të njëjtin nivel siç janë përcaktuar me vendimin për përcaktimin e çmimeve më të larta të shitjes me pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit të datës 19.04.2021.

Çmimi i shitjes me pakicë i benzinës **EUROSUPER BS-95 ulet për 0,50 denarë/litër**.
Ulje ka edhe te çmimi i shitjes me pakicë të Mazutit M-1 SU për 0,400 den/kg dhe tani do të jetë 34,592 den/kg.

Nga data 27.4.2021, ora 00:01 çmimet maksimale të derivateve të naftës do të jenë:

Benzinë për motorë	EUROSUPER BS - 95	67,00 (denarë/litër)
Benzinë për motorë	EUROSUPER BS -98	69,00 (denarë/litër)
Naftë për motorë	EURODIZEL BS (D-E V)	58,50 (denarë/litër)
Vaj për Djegie	Ekstra i Lehtë 1 (EL-1)	58,00 (denarë/litër)
Mazut M-1 SU		34,592 (denarë/kilogram)

Në periudhën e kaluar shtatëditore, **çmimet referente në bursat botërore** shënojnë ulje te benzina mesatarisht për 0,242%, te nafta ka rritje për 0,742%, te vaji ekstra i lehtë gjithashtu ka rritje për 0,902 %, ndërsa te mazuti ka ulje për 0,543% .

Në të njëjtën periudhë **kursi i denarit në raport me dollarin është më i ulët për 0,844%**.

Theksojmë se këto janë çmimet maksimale të derivateve të naftës nga ora 00:01 e datës 27.4.2021. Tregtarët me shumicë dhe pakicë me derivate të naftës dhe lëndë djegëse për transport, mund t'i formulojnë çmimet e derivateve të ndryshme të naftës dhe lëndëve djegëse për transport edhe më të ulëta se çmimet më të larta që janë përcaktuar.

Çmimet e shitjes me pakicë të EURODIZELIT dhe EUROSUPER BS – 95 në Maqedoninë e Veriut dhe disa vende të BE-së (https://ec.europa.eu/energy/data-analysis/weekly-oil-bulletin_en datë 19.4.2021), janë dhënë në tabelën në vijim:



Tabela 1. Çmimet e shitjes me pakicë të Eurodizelit dhe të Eurosuperit BS-95 (çmimet në vendet e UE-së janë nga data 19 prill 2021)

	Eurodizel (EUR)	EUROSUPER BS-95 (EUR)
Maqedonia e Veriut	0,950	1,088
Austria	1,168	1,225
Bullgaria	1,081	1,081
Kroacia	1,283	1,357
Gjermania	1,310	1,526
Greqia	1,319	1,600
Italia	1,436	1,574
Hungaria	1,160	1,167
Sllovenia	1,185	1,173

26.4.2021